


GUIDA PËR EMERGJENCAT CIVILE NË SHKOLLAT PROFESIONALE



Tiranë, Dhjetor 2023

Deklarata e autorit

©Kjo guidë është e shkruar për herë të parë duke prezantuar një kërkim original në kuadër të projektit dhe nuk prezanton qendrim zyrtar të organizatës Save the Children Albania.

Hyrje

Save the Children Albania në vijim të misionit dhe vizionit për të rinj më të sigurt dhe të fuqizuar në vendin tonë, është duke implementuar projektin ‘POWER for AYs’-Për mirëqenien më të sigurt të të rinjve përmes modelit social-ekologjik’. Në kuadër të këtij projekti, guida mbi emergjencat civile në shkollat profesionale shërben si një udhërrëfyes për të gjithë aktorët që punojnë në shkollat profesionale dhe në mënyrë specifike për vetë të rinjtë për të kuptuar dhe menaxhuar rreziqet që shkaktohen në kuadër të emergjencave civile në ambientin që ata frekuentojnë më shumë në ditën e tyre.

Kjo guidë, e hartuar përmes kombinimit të informacionit teorik dhe atij praktik të zhvilluar përgjatë sesioneve të trajnimit në shkollat profesionale Cërrik, Dibër dhe Bushat synon të ofrojë një panoramë të përditësuar të konceptimit dhe menaxhimit të emergjencave civile në shkollat profesionale. Guida shërben si një dokument i cili mund të adaptojë dhe prodhojë në mënyrë të menjëhershme planin e emergjencave civile specifik për secilën shkollë.

Emergjencat civile nuk janë çështje që i adresohen vetëm policisë, ushtrisë apo institucioneve shtetërore, ato kthehen në kauzë të rëndësishme, ku çdo informacion dhe edukim informues ndaj tyre, i shërben sigurisë dhe mirëqenies së të rinjve që ndjekin shkollat profesionale dhe të individit në tërësi.

Mirënjohje

Kjo guidë është një produkt i disa aktorëve të cilët mundësuan identifikimin e kauzave aktuale dhe relevante për shkollat profesionale. Një falenderim me mirënjohje shkon për drejtuesit e shkollave profesionale Dibër ‘Nazmi Rushiti’, ‘Mihal Shahini’ Cërrik si dhe ‘Ndre Mjeda’ Bushat. Mësuesit e shkollave profesionale ofruan praktikën e tyre dhe sfidat që nxënësit kanë në qasjen dhe konceptimin e duhur të emergjencave civile në jetën e tyre, dhe specifikisht në ambientet e shkollës. Nxënësit pjesëmarrës në takim, prezantuan një qasje interesante se si ata mund të jenë vetë ‘fuqizuesit’ e përcjelljes së kësaj kauze mes nxënësve të tjerë. Gjithashtu, pjesëmarrja e stafëve mbështetëse duke treguar mbështetjen e tyre për formësimin sa më të mirë të dokumentacionit të emergjencave civile, edukimit më gjerë për këtë specifikë si dhe simulimin e rasteve të emergjencave civile përgjatë vitit, ndihmuan në realizimin me qasjen e duhur të kombinuar teorike-praktike të kësaj guide. Mirënjohje edhe stafit dhe ekspertëve të angazhuar nga Save the Children që u dedikuan në përpilimin e kësaj guide me elementët e duhur.

Tabela e përmbajtjes

Deklarata e autorit	2
Hyrje.....	3
Mirënjohje	4
Tabela e përmbajtjes	5
Shkurtime	6
Metodologjia.....	8
I. Si të ndërtoj planin e emergjencave civile në shkollën time – politikat dhe legjislacioni aktual	9
II. Mekanizmi institucional dhe strukturat e nevojshme në shkollën profesionale	12
III. Specifikat dhe llojet e planit të emergjencave civile.....	15
IV. Menaxhimi i rasteve të emergjencave civile.....	18
Aneks dhe ilustrime.....	24
Bibliografia	25

Bashkimi Evropian	BE
Baza e Mbrojtjes Civile	BMC
Departamenti i Planifikimit të Emergjencave Civile	DPPEC
Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile	DPKEC
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve	DPRr
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve	DPUK
Drejtoria e Ujërave	DU
Drejtuesi i Operacionit në Qark	DOQ
Drejtuesi Qendror i Operacionit	DQO
Emergjencë Civile	EC
Enti Kombëtar i Banesave	EKB
Forcat e Armatosura	FA
Forcat Operacionale	FO
Gjendje e Emergjencës Civile	GJEC
Grupi i OKB për Vlerësimin dhe Bashkërendimin e Fatkeqësive	UNDAC
Grupi Ndërkombëtar Këshillues i Kërkim Shpëtimit	INSARAG
Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes Civile	IKMC
Instituti i Fizikës Bërthamore	IFB
Instituti i Hidrometeorologjisë	IH
Instituti i Sizmologjisë	IS
Instituti i Studimeve Urbanistike	ISU
Kërkim – Shpëtimi	SAR
Këshilli i Ministrave	KM
Këshilli i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.	KRRTT
Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.	KRRTRSH
Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark.	KPPECQ
Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark	KPPECQ
Komisioni Teknik Këshillimor i Specialistëve të Emergjencave Civile.	KTKSEC
Komisioni Vendor i Emergjencave Civile	KVEC

¹ Në këtë seksion ju ofrohen termat me shkurtesat përkatëse që përdoren si terminologji për emergjencat civile në dokumenta politikë dhe ligjorë të ndryshëm në vendin tonë.

Komisioni Vendor i Emergjencave Civile.	KVEC
Komisionin e Emergjencave Civile në Qark	KECQ
Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile	KNEC
Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile	KNEC
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	KESH
Kryqi i Kuq Shqiptar	KKSH
Ministria e Punëve të Brendshme	MPB
Ministria e Mbrojtjes	MM
Organizata Jo Qeveritare	OJQ
Organizata Qeveritare	OQ
Plani i Qarkut për Emergjencat Civile	PQEC
Plani i Emergjencave Civile	PEC
Shkolla Profesionale	SHP

Metodologjia

Projekti kërkon të mbështesë shkollat profesionale për të konceptuar dhe implementuar qartë planin e tyre të emergjencave (DRR) për adoleshentët dhe të rinjtë. Përpilimi i një materiali përmbledhës për DRR kërkon përshtatjen e moduleve ekzistuese të deritanishme të Save the Children për të ofruar një manual/guidë të shkollat profesionale, duke i aftësuar ata me teknikat kompetente për të patur/hartuar një plan të mëvetësishëm të tyre. Me qëllim përmbushjen dhe realizimin e objektivave do të merren në konsideratë këto aspekte metodologjike:

a. Desk review research: hulumtimi i manualeve, guidave apo artikujve të tjerë relevantë mbi DRR: duke hulumtuar paralelisht në planin kombëtar, evropian dhe atë ndërkombëtar. Praktikrat e ndërtuara deri tani nga Save the Children do të mbahen në një vëmendje specifike në kuadër të kërimit paraprak.

b. Aspekte statistikore-cilësore: të marra si feedback/rezultat nga trajnimi që do të zhvillohet me stafet e shkollave profesionale si dhe nga burime të tjera të statistikave që INSTAT dhe Ministria e Brendshme ofron lidhur me këtë aspekt.

c. Zhvillimi i intervistave të strukturuar (si pjesë integrale e trajnimeve) me qëllim evidentimin e problematikave reale të pjesëmarrësve në secilin qytet. Referimi në aspekte specifike të problematikave të llojit të emergjencave civile si dhe menaxheriale në shkollat përkatëse do të merret parasysh në hartimin dhe funksionalitetin që kjo guidë synon të shërbejë.

Dokumenti i integruar do të kombinojë gjuhën e kërimit teorik me praktikën dhe nevojën adekuade të shkollave profesionale që do të jenë pjesë e projektit në tre qytetet Elbasan, Shkodër, Dibër. Kjo guidë do t'u ofrojë aktorëve të shkollave profesionale kompetenca në nivel njohurie dhe praktike në tre shtylla kryesore:

I. Dokumentat dhe strategjitë përkatëse në fuqi referuar kësaj kauze.

2. Udhëzime praktike se si të ndërtohet plani i emergjencave civile në shkollën profesionale.

3. Shembuj praktik se si duhen menaxhuar lloje të ndryshme të emergjencave civile.

4. Hapat udhëzues të vlerësimit dhe menaxhimit të emergjencave civile në shkollat profesionale.

Guida do të referojë specifikisht një larmi burimesh të vlefshme për t'u mbajtur në konsultime të vazhdueshme nga stafet e shkollave profesionale dhe më gjerë.

I. Si të ndërtoj planin e emergjencave civile në shkollën time – politikat dhe legjislacioni aktual



Stafet, nxënësit, punojësit mbështetës dhe aktorët e tjerë të shkollave profesionale duhet të udhëhiqen përgjatë veprimtarisë së tyre jo vetëm nga dijet dhe kompetencat e marra si profesionistë, por edhe nga legjislacioni shqiptar në fushën e emergjencave civile. Për aq sa është e nevojshme, ata duhet të zotërojnë njohuritë e duhura duke u referuar në këtë panoramë legjislative:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: e cila përmes Nenit 101 prezaton faktin se Këshilli i Ministrave përcakton akte normative me fuqinë e ligjit në raste urgjence dhe nevojë. Këto akte normative do duhet të jenë në fokus njohjeje nga shërbimet shoqërore në rastin e një emergjence civile. Rasti i pandemisë covid19 është ilustrues për të patur një vëmendje të tillë ndaj nenit 101 të Kushtetutës së vendit. Emergjencat civile përpara se të jenë një dimension politik-ligjor, janë dimensione për të cilat Kushtetuta fillimisht hap portën duke i pozicionuar si tejet të rëndësishme.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare: përgjithësisht janë marrëveshjet e nënshkruara nga Këshilli i Ministrave me qeveritë e vendeve të tjera për bashkëpunim në fushën e emergjencave civile. Një marrëveshje të tillë kemi me Republikën e Kosovës.² Një njohuri e tillë është e domosdoshme, pasi u mundëson strukturave të adresojnë dhe kërkojnë elementë bashkëpunues si psh: shtimi i burimeve njerëzore në strukturat e shërbimeve shoqërore për menaxhimin e emergjencave civile, kërkimi i fondeve, mjeteve etj. Në këtë kuadër, përgjithësisht strukturat e shkollave profesionale janë ‘pritëse’ të vendimmarrjeve të realizuara nga qeveria, por gjithsesi mund të kemi edhe anën tjetër të medaljes: ku vetë strukturat e shkollave profesionale të jenë ato që të adresojnë dhe iniciojnë ‘portën’ e ndihmës.

3. Ligjet: Shkollat profesionale duhet t’i kushtojnë vëmendje specifike ligjit për emergjencat civile sa i përket rolit të tyre në këtë fushë, por jo pa patur në vëmendje edhe ligjet e tjera që lidhen me rolin dhe aspekte të tjera. Një listë referuese gjendet si më poshtë:

- Ligji 15/2017 ‘Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë’
- Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”
- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”

² <https://www.mod.gov.al/newsroom-2/4552-marreveshje-ndermjet-keshillit-te-ministrave-dhe-qeverise-se-kosoves-per-bashkepunim-dhe-ndihme-te-ndersjelle-ne-raste-te-fatkeqesive-natyrore-dhe-fatkeqesive-te-tjera>

- Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar
- Ligji Nr. 163/2014, “Për Urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me Ligjin 120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

4. Aktet e pushtetit ekzekutiv: Këshilli i Ministrave ose Ministri të ndryshme (kryesisht ajo e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Brendshme) prodhojnë vendimet e tyre, të cilat detajojnë më tej parashikimet ligjore për emergjencat civile. Një tablo referuese në këtë kontekst është si më poshtë:

- VKM nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”;
- VKM 518 dt 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;
- VKM 578 dt.03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;
- VKM nr.505, datë 13.07.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”;
- VKM nr. 499, datë 29.8.2018 për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit;
- VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”;
- VKM Nr. 136, datë 07.03.2018, “Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”
- Udhëzim nr. 911 dt.27.12.2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”;
- Udhëzim nr.13, datë 17.12.2012 “Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”;
- Vendim nr. 327, datë 2.6.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”
- Udhëzim nr. 744, datë 15.11.2019 “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)”;
- Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit”

- Vendim nr. 195, datë 11.4.2007 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”
- Vendim nr. 821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”
- Vendim nr. 822, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”
- Vendim nr.823, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat ditore”
- Vendim nr.752, datë 8.9.2010 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në nevojë”
- Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit”
- Udhëzim nr.597, datë 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror, asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuar”
- Udhëzim nr. 582, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, në qendrat shtëpi familje, për fëmijët 16–18 vjeç”.

Në këtë tablo, një pjesë e konsiderueshme kanë qenë edhe vendimet lidhur me menaxhimin e pandemisë covid19, të cilat parashikonin elementë të konsiderueshëm për t’u menaxhuar nga pushteti vendor si: shpërndarja e ushqimeve, produkteve farmaceutike, identifikimi i rasteve etj.³

5. Aktet e pushtetit vendor: Bashkitë e qyteteve në të cilat është implementuar projekti, disponojnë qoftë në nivel bashkie apo prefekturë planet specifike të Emergjencave Civile. Edhe pse ky informacion nuk është lehtësisht i përditësuar në ëbsite zyrtare të Bashkive apo Prefekturave, rekomadohet që gjatë hartimit të dokumentit të Planit të Emergjencave Civile në Shkollën Profesionale konsultimi dhe mbajtja në vëmendje e kësaj porte legislative të mbahet në konsideratë.

Njëkohësisht, ka dhe një serë dokumentash në nivel politik apo ligjor të cilat mund t’i vijnë në ndihmë guidës:

PLANI NDËRKOMBËTAR

Save the Children International practice and documents for disaster risk reduction such as Lessons Learned from Implementing Integrated Child Protection and Disaster Risk Reduction in the Deep South of Thailand and Mindanao in the Philippines and other relevant documents
<https://resourcecentre.savethechildren.net/topics/disaster-risk-reduction-drr/>

³ Shënim: Evidentimi dhe renditja e akteve të mësipërme është bazuar në ëbsite <https://www.sherbimisocial.gov.al/institucione-perkujdesi/legislacioni/>, si dhe nw web www.qbz.gov.al si dhe www.ligjet.org

PLANI EVROPIAN

Regulation and implementing actions of EU Civil Protection Mechanism and Disaster Risk Assessment from EU Commission https://civil-protection-humanitarian-aid.ec.europa.eu/who/about-echo/legal-framework_en

PLANI KOMBËTAR

Save the Children Albania practice on DRR https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Disaster%20Risk%20Reduction%5B1%5D_0.pdf , <https://albania.savethechildren.net/resources/humanitarian/t-48/sort-type-asc>

National Plan for Civil Emergencies (Ministry of Defence) Plani Kombëtar i Emergjencave Civile⁴

➤ Në rast se ju duhet që të jeni një nga anëtarët e shkrimit të dokumentit të Planit të Emergjencave Civile, mos harroni që t'i referoheni:

- Kushtetutës
- Marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj apo marrëveshjeve të tjera me shtetet e huaja (rasti i Kovës psh)
- Ligjeve, kryesisht ligjit për arsimin profesional dhe atij të mbrojtjes civile
- Planit Kombëtar të Emergjencave Civile të miratuar me VKM
- Planit Vendor të Emergjencave Civile në nivel bashkie apo prefekturë: Konsultohuni me Ministrinë e Financave si dhe me bashkinë, prefekturën tuaj lidhur me këtë aspekt.
- Dokumentave të tjera ndihmëse të organizatave ndërkombëtare të huaja
- Praktikave të mpëarshme (sado sporadike) në fushën e emergjencave civile në shkollën tuaj.

II. Mekanizmi institucional dhe strukturat e nevojshme në shkollën profesionale

Shkollat Profesionale duhet që përtej njohurive në dokumentat relevante ligjorë, politikë dhe të tjera që lidhen me planin e emergjencave civile, duhet që të përcaktojnë qartë koordinimin e strukturave brenda tyre si dhe nivelin e duhur koordinues me strukturat relevante të pushtetit vendor dhe atij qendror. Më poshtë gjeni disa tabela se si ju mund të orientoheni në mënyrë efektive në nivel strukturor:

Struktura	Kompetencat
Drejtori	➤ Monitoruesi i vazhdueshëm ➤ Plan i Emergjencave Civile mund të nisë si një iniciativë në kuadër të

⁴ https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_630_PKEC.pdf Pas pandemisë covid dhe tërmetit 2019, ka një serë draftesh dhe projektvekm për ndryshimin e planit kombëtar të emergjencave civile

	strategjive të brendshme të Drejtorisë së Shkollës, jo vetëm duke pritur udhëzimet që vijnë nga Ministria apo pushteti vendor. ➤ Në hartimin apo edhe në implementimin e emergjencave civile drejtori i shkollës cilësohet dhe konsiderohet si monitoruesi i vazhdueshëm i gjithë procesit ➤ Mos harro: rol koordinues me instanca të tjera me bashkinë dhe prefekturën, drejtoritë e emergjencave civile si dhe të tjerë që duhet për menaxhimin e emergjencave civile.
Zv.Drejtorët	➤ Pritësit e feedback dhe hartuesit e ndarjeve të detyrave me stafin e nxënësit ➤ Zv.Drejtorët cilësohen si ura lidhëse mes aktorëve të tjerë brenda dhe jashtë shkollës me drejtorinë e shkollës ➤ Zv.Drejtorët janë ata që ‘e mbajnë aktiv’ kauzën e emergjencave civile në shkollën e tyre.
Mësues	Kontakti me nxënësit dhe menaxhimi i mikroklimave të tyre sin ë planin informues ashtu dhe në atë zbatues Psh: simulimi i rasteve të emergjencave civile në orët mësimore Informimi gjatë një ore mësimore ose si aktivitet i mëvetësishëm për emergjencat civile.
Bordi i Prindërve	Suportues dhe mirëkuptues Do të duhen jo vetëm të ‘dalin në pah’ sa herë thirren nga shkolla, por duhet të jenë ata që suportojnë fushatat informuese dhe advokuese si dhe mund të kërkojnë mbështetje të fondeve strukturore me instanca të tjera
Senati	Ndryshime dhe përditësim politikash Nxënësit e Senatit të Shkollës duhet të jenë ‘motori’ lëvizës i informimit dhe advokimit të emergjencave civile mes

	nxënësve të shkollës duke siguruar vazhdimisht gjithëpërfshirje
Nxënës	Simulime të vazhdueshme – informim Nxënësit duhet të kalojnë nga statusi i të qenit 'I ftuar' në aktivitetet ndërgjegjësuere dhe të tjera të emergjencave civile në 'aktivët e parë' të emergjencave civile
Staf mbështetës	Rojet, pastruesit dhe të tjerë anëtarë të stafit mbështetës nevojitet të jenë prezent dhe të trajnohen vazhdimisht për emergjencat civile, kryesisht për aspekte teknike të ambientit të shkollës që lidhen me sigurinë
Sekretaria	Kryesisht kërkohet të mbajë të dhëna, krijimi i një database në rastet e emergjencave civile duke koordinuar me regjistrin e përgjithshëm të të dhënave të nxënësve

Pozicionimi i saktë i strukturave me të tillë nivel kompetencash gjatë hartimit të planit të emergjencave civile do të lehtësojë qasjen e duhur të kësaj kauze në gjithë ambientin e aktorëve që funksionojnë brenda shkollës.

MOS HARRO: Duhet që shkolla profesionale të ketë në vëmendje edhe këto struktura të jashtme gjatë menaxhimit të emergjencave civile:

- a. Drejtorinë përkatëse të Emergjencave Civile pranë Bashkisë
- b. Drejtorinë Operacionale në Prefekturë
- c. Këshillin Bashkiak dhe Këshillin e Qarkut
- d. Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit si relevante me funksionin e shkollës profesionale
- e. Policia, Zjarrëfikësja, Forcat e Armatosura, Grupet vullnetare

HARTIMI DHE MENAXHIMI I EMERGJENCAVE CIVILE NË SHKOLLAT PROFESIONALE

- Hartimi i planit
- Miratimi i planit
- Miratimi i buxhetit specifik (NËSE)
- Ngritja e strukturave përkatëse

- Trajnine dhe advokime të stafit
- Ngritja e grupeve vullnetare
- Bashkëpunime specifike të strukturave të shërbimeve shoqërore me të tjera brenda bashkisë
- Bashkëpunime të strukturave të shërbimeve shoqërore me struktura të tjera vendore
- Me aktorë të tjerë: shkolla, qendra shëndetësore, prefektura, të tjera kombëtare?.....

III. Specifikat dhe llojet e planit të emergjencave civile

A. TËRMET

Tërmeti dhe pasojat e tij të tmerrshme janë ndër fenomenet më të frikshme dhe shkatërruese të natyrës. Tërmeti është një tronditje papritur dhe e shpejtë e tokës, që shkaktohet nga çarja dhe zhvendosja e shkëmbinjve nëntokësor ndërsa çliron tendosjen që ka mbledhur për një kohë të gjatë.

Si të përgatitemi PARA TËRMETIT

Ndiqu këshillat e mëposhtme për të mbrojtur vehten, familjen dhe pronën tuaj në rastin e një tërmeti

- Informohuni për rregullat dhe masat që merren në raste emergjencash.
- Mbani në shtëpi një kuti të ndihmës së shpejtë. Sigurohuni që çdo pjesëtar i familjes ta dijë vendndodhjen e saj.
- Fiksoni mirë në mur mobilet e rënda sepse mund t'ju biensipër gjatë tërmetit.
- Fiksoni mirë në mur sendet e rënda si piktura dhe pasqyra dhe vendosini larg krevateve, divanëve dhe kolltuqeve ku njerëzit ulen.
- Shmangni mbajtjen e objekteve të rënda në raftet e larta.
- Vendosni sendet që mund të thyhen (shishet prej qelqi, enët e kuzhinës etj) në raftet e ulëta, mundësisht të mbyllura me kyç.
- Informohuni se ku ndodhen dhe si mbyllen rubinetat e gazit, ujit dhe automati i dritave sepse këto impiante pësojnë dëme nga tërmeti.
- Riparoni instalimet elektrike dhe lidhjet e gazit që mund të jenë me defekt. Ato përbëjnë rrezik të mundshëm për zjarr. Mos i riparoni vetë por thërrisni për ndihmë profesionistët që dinë si të punojnë me to.
- Krijoni vende të sigurta në çdo dhomë (hapësira nën një tavolinë të fortë është një vend i sigurt).
- Praktikoni në shtëpi me familjen tuaj si do të silleshit në rastin e një tërmeti: Përkulu në dysheme! Mbulohu! Qendro dhe mbahu fort!

Si të reagojmë GJATË TËRMETIT



1. Përkuluni në dysheme! Tërmetet ndodhin pa paralajmëruar. Sapo të ndjeni lëkundjet e para përkuluni në dysheme.

• Mos vraponi përjashta ose për në dhomat e tjera gjatë lëkundjeve dhe tronditjeve të tërmetit!
• Mos qëndroni poshtë derës!
• Mos vraponi për në dhomën tjetër për tu futur poshtë tavolinës!
• Mos vraponi! Mund të ketë tronditje të forta. Mund të ketë copa xhamitë thyera dhe sende që kanë rënë dhe ju bllokojnë daljen.
• Mos vraponi drej shkallëve! Shkallët janë pjesa më pak e stabilizuar enjë ndërtese.
• Mos përdorni ashensorin! Ashensori mund të bllokohet.

Çfarë të bëjmë PASTËRMETIT

- Sigurohuni për gjendjen shëndetësore të njerëzve që ndodhen pranë jush. Ndhmoni ata që ndodhen në vështirësi dhe jepuni ndihmën e parë.
- Mos i lëvizni personat që janë lënduar shumë, sepse mund ta rëndoni më tepër gjendjen e tyre.
- Dilni me kujdes nga vendi ku ndodheni. Mos harroni të vishni këpucët sepse në rrugë mund të ketë copa xhami të thyer dhe sende të tjera.
- Shkoni dhe qëndroni në vende të hapura larg ndërtesave dhe strukturave të tjera të rrezikshme; ekziston rreziku t'ju bien sipër.
- Qëndroni larg uzinave industriale dhe kabinave elektrike; afër tyre mund të ndodhë ndonjë aksident.
- Qëndroni larg bregdetit apo buzë liqenit; mund të shkaktohet ndonjë Tsunam.
- Mos përdorni telefonat sepse mund të ngarkoni linjën telefonike duke përgjatur të tjerët që kanë vërtet nevojë për ndihmën e shpejtë.

b. ZJARRET

SIT'I SHMANGIM ZJARRET

- Mos hidhni bishtat e cigareve apo shkrepsat e pafikura në tokë; ato rrezikojnë të shkaktojnë zjarr.
- Mos ndizni zjarr në pyll! Është e ndaluar dhe shumë e rrezikshme.
- Mos hidhni mbeturina në pyje; ato mund të përbëjnë lëndë djegëse dhe mund të shkaktojnë zjarre.
- Mos digjini sende pa marrë masat e duhura mbrojtëse ndaj zjarrit; situata mund t'ju dalë jashtë kontrollit.
- Kujdes kur parkoni makinën, sigurohuni që marmita nuk është afërbarit të thatë sepse marmita e nxehur mund të shkaktojë ndezje zjarrit.

Kujdes gjatë përdorimit të Pajisjeve Elektrike!

- Kontrolloni vazhdimisht instalimet elektrike dhe pajisjet për çarje apo zhveshje të mundshme.
- Mos ngarkoni rrjetin elektrik dhe prizat me pajisje si sobë, lavatriçe, hekur etj.
- Asnjëherë mos përdorni kablllo të dëmtuara dhe mos i vendosni pranë sipërfaqeve të nxehta, pranë ujit, përgjatë derve të hyrjes apo poshtë tapeteve.
- Nëse ndjeni erë të rëndë, bëni kujdes, kontrolloni, mund të jenë shenjat e para të zjarrit. Menjëherë ulni ndërprerësin e energjisë elektrike, pajisjeve me gaz dhe lëndëve djegëse.
- Përdorni bombula të sigurta, të cilat kanë të shënuar karakteristikat e tyre.
- Ajrosni vazhdimisht dhomat duke mbajtur dyert ose dritaret hapur për të parandaluar ndotjen e ajrit brenda shtëpisë.
- Kontrolloni teknikisht dhe pastroni pajisjet me gaz çdo vit.

SITË REAGJOMË NË RASTE ZJARRI

- Kur ndjeni erë të rëndë, konstatooni tym ose shihni rrjedhje gazi, reagoni menjëherë:
 - Lajmëroni të gjithë pjesëtarët e familjes
 - Mbyllni valvulën kryesore të gazit
 - Ulni çelësin kryesor të energjisë elektrike
 - Hapni të gjitha dyert dhe dritaret për të bërë të mundur qarkullimin e ajrit
 - Qëndroni i qetë dhe ndihmoni pjesëtarët e familjes të dalin jashtë ambienteve të shtëpisë
 - Mos ndizni në asnjë mënyrë shkrepse apo çakmak, të cilët mund të shkaktojnë shpërthime
-
- Telefononi menjëherë **Zjarrëfikset në numrin 128 (shërbim falas)** nëse shikoni zjarr ose tym diku. Jepni informacion sa më të saktë për vendndodhjen e zjarrit.
 - Mos qëndroni në vende ku fryn erë sepse flakët mund të rriten shpejt.
 - Shtrihuni përtokë në një vend ku nuk ka sende që mund të marrin flakë. Tymi ka si veçori të ngjitet lart dhe duke u shtrirë përtokë mund të shpëtoni nga asfiksioni.
 - Kur ju duhet patjetër të kaloni zjarrin për të shkuar në një vend më të sigurt, mundohuni të gjeni vendin që ka më pak flakë dhe të kaloni në zonën që është djegur tashmë.



c. SIT'I PARANDALOJMË PËRMBYTJET

- Informohuni nëse jeni në një zonë të rrezikuar ose të predispozuar për tu përmbytur.
- Informohuni nëse shtëpia apo prona juaj është e ndërtuar nën apombi nivelin e rrezikuar për tu përmbytur.
- Mos ndërtoni pranë rrjedhës së lumit.
- Mos ndërtoni në zona me rrezik ose të predispozuar për tu përmbytur.
- Mbillni pemë! Pemët ndihmojnë në parandalimin e përmbytjeve duke thithur ujin dhe parandaluar edhe rrëshqitjet e tokës.

Si të reagojmë PARA PËRMBYTJEVE

- Jini të përgatitur. Përgatisni një çantë me çfarë ju nevojitet nëse dot'ju duhet të evakuoheni. Mos harroni të vendosni ilaçet që mund t'ju nevojiten.
- Nëse keni mundësi, lëvizini pajisjet elektroshtëpiake në katet më të larta.
- Largohuni menjëherë nga shtëpia nëse ju këshillohet të evakuoheni.
- Mbyllni gazin, ulni automatin e energjisë elektrike për t'i mbrojtur më shumë pajisjet.

Si të reagojmë GJATË PËRMBYTJEVE

- Vishuni me rroba që nuk përshkohen nga uji; nëse jeni për një kohë të gjatë në lagështi, rrezikoni të sëmurëni.
- Mos përdorni telefonat sepse mund të ngarkoni linjën telefonike duke penguar të tjerët që kanë vërtet nevojë për ndihmën e shpejtë.
- Mos kaloni mbi urën e një lumi që mund të jetë i fryer, niveli i ujit rrezikon të rritet dhe të vijë mbi urë.
- Shmangni qarkullimin me makinë në rrugë të prekura nga përmbytjet sepse uji mund t'ju bllokojë makinën. Nëse ju ndodhë makina ju bllokohet nga uji, largohuni menjëherë në një vend më të lartë nëse mund të lëvizni pa rrezikuar.
- Mos ecni nëpër ujë që lëviz. Mund të rrëzoheni.
- Mos prekni pajisje elektrike nëse jeni të lagur apo nëse jeni në ujë.

NË MENAXHIMIN E LLOJEVE TË EMERGJENCAVE CIVILE, SHKOLLAT PROFESIONALE DUHET QË:

A. Të informojnë me listën e masave që duhet marrë në rastet tipike të emergjencave civile: tërmet, përmbytje, zjarr

B. Për rastin e Dibrës: të tilla masa duhen përshtatur edhe me situatën e orteqeve/borës kryesisht lidhur me transportimin e nxënësve dhe stafit për zonat përreth.

NUMRAT E EMERGJENCËS

Linja e emergjencës	112
Ambulanca	127
Zjarrfikset	128
Policia	129
Policia rrugore	126

IV. Menaxhimi i rasteve të emergjencave civile

I. LINJA E RREZIKUT

Në varësi të vendndodhjes së komunitetit, disa rreziqe mund të kenë më shumë gjasa të ndodhin. Për shembull, njerëzit që jetojnë në një ishull tropikal nuk duhet të përgatiten për një stuhë arktike, por mund të kenë nevojë të përgatiten për rreziqet e cunamit. Është e rëndësishme të kuptoni rreziqet tuaja, në mënyrë që të mund të ndërmerrni veprimet e duhura për t'u përgatitur për rreziqet për të ndihmuar në parandalimin e shndërrimit të ndikimeve të tyre në një fatkeqësi. Meqenëse rreziqe të caktuara mund të ndodhin rregullisht në komunitetet lokale, ata mund të kenë njohuri lokale se si të përgatiten. Njohuritë e tyre lokale dhe teknikat e gatishmërisë janë të rëndësishme për t'u kapur dhe praktikuar për të ndihmuar në menaxhimin e rreziqeve lokale të fatkeqësive.

Hapi 1

Mendoni për komunitetin tuaj. Çfarë rreziqesh ndodhin rregullisht aty ku jetoni?

Hapi 2

Flisni me të vjetrit në komunitetin tuaj për të mësuar më shumë rreth rreziqeve që ka përjetuar zona juaj. Me lejen e tyre, ju mund të dëshironi të mbani shënime ose të regjistroni tregimin e tyre për të ndihmuar në kapjen e udhëzimeve të tyre të mira.

Çfarë bën komuniteti juaj për t'u përgatitur? A është kthyer ndonjë rrezik në fatkeqësi, nëse po, çfarë reagoi komuniteti juaj gjatë ngjarjes dhe të rikuperohej më pas? A përjetuan ndonjë rrezik në komunitet kur ishin duke u rritur? A janë rreziqet që ka përjetuar komuniteti juaj në atë kohë më ndryshe nga ajo që përjetohet në ditët e sotme? Jini kureshtar për përvojat e tyre për të mësuar më shumë për historinë e komunitetit tuaj.

Hapi 3

Mendoni se si mund ta ndani historinë e tyre me bashkëmoshatarët tuaj ose brezat e rinj për të ndihmuar që komuniteti juaj të vazhdojë të ndërtojë traditat tuaja lokale të gatishmërisë.

II. LOJË E KUPTIMIT SË RREZIKUT

Rreziqet janë "një fenomen, substancë, aktivitet njerëzor ose gjendje e rrezikshme që mund të shkaktojë humbje jete, lëndime ose ndikime të tjera shëndetësore, dëmtime të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, përçarje sociale dhe ekonomike ose dëmtim mjedisor".

Rreziqet nuk duhet të kthehen në fatkeqësi. Njohja e rreziqeve tuaja nga fatkeqësitë dhe hapat e thjeshtë të gatishmërisë mund t'ju ndihmojnë të zvogëloni cenueshmërinë tuaj dhe të forconi qëndrueshmërinë tuaj ndaj fatkeqësive. Emergjencat mund të ndodhin në çdo kohë dhe pa paralajmërim. Çdo anëtar në familjen tuaj mund të ketë nevoja individuale që duhet të adresohen në mënyrë që të përgatitet siç duhet për t'iu përgjigjur në rast urgjence. Mendoni se si gjërat si mosha, paaftësia, gjinia, gjendja shëndetësore, nevojat gjuhësore, etj. mund të ndikojnë në mënyrën se si njerëzit duhet të përgatiten për t'u përgjigjur në situata emergjente. Krijoni 4 skena të ndryshme rreziku për të demonstruar nevojat e ndryshme të gatishmërisë dhe reagimit për njerëzit.

III. KUPTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË

Rreziku i fatkeqësisë llogaritet duke kuptuar se cilat rreziqe ka të ngjarë të ndodhin në një zonë, duke vlerësuar se ku komunitetet mund të ndikohen negativisht nga një rrezik dhe duke identifikuar një sërë faktorësh njerëzorë që ndikojnë në aftësinë e njerëzve për t'u përgatitur, për t'iu përgjigjur dhe për t'u rikuperuar nga një fatkeqësi. Duke kuptuar dhe trajtuar rreziqet e tyre nga fatkeqësitë, komunitetet e pajisura me njohuri dhe burime kanë.

IV. NDËRTO NJË KIT EMERGJENCE: Gjuetia e PASURIVE

Një nga hapat themelorë që mund të bëni për t'u përgatitur për një emergjencë është të keni një komplet furnizimesh emergjence. Ju mund të bëni një çantë për të qëndruar në shtëpinë, shkollën, makinën ose vendin tuaj punoni, ose mund të bëni një më të vogël që është e lehtë për t'u rrëmbyer dhe për të shkuar në rast se ju nevojitet evakuoj. Ky ushtrim do t'ju ndihmojë të mësoni se çfarë mund të jetë në kompletin tuaj.

Hapi 1

Ndani klasën në dy ekipe. Një ekip do t'i fshehë furnizimet dhe skuadra tjetër do t'i gjejë ato për t'i vendosur çantën e urgjencës. Ekipet do të ndryshojnë rolet në fund.

Hapi 2

Mblidhni të gjithë artikujt që i përkasin një complete emergjence që ekipi i parë të fshihet rreth klasës ose ndërtesës së shkollës. Artikujt e fshehur duhet të përfshijnë materiale të rekomanduara në një çantë urgjence, por duhet të përfshijnë edhe disa gjëra të padobishme që nuk i përkasin një çantë të përshtatshme për ta bërë më të vështirë gjetjen e gjithçkaje dhe fitimin.

Hapi 3

Burimet. Bëni një listë të artikujve të fshehur. Tregoni se cilët artikuj janë të rekomanduar ose jo thelbësor. Artikujt që artikujt e kompletit rekomandohen për një komplet urgjence do të fitojnë 3 pikë, ndërsa artikujt jo thelbësorë do të fitojnë 1 pikë.

Hapi 4

Jepini ekipit të dytë një listë të sendeve të fshehura për t'i gjetur në pesë minuta. Vendosni kohëmatësin për pesë minuta. Në fund të lojës fiton skuadra me më shumë pikë.

V. HARTA E RREZIKUT NË KLASË

Mendoni se çfarë rreziqesh ndodhin aty ku jetoni. Nëse një rrezik goditet gjatë kohës që keni qenë në shkollë, a keni një ide se si do të ndikohej shkolla juaj? Duke bërë një hartë rreziku, ju mund të identifikojë se çfarë ndryshimesh të thjeshta mund të bëhen për t'ju ndihmuar të bëni ju dhe shokët tuaj të klasës më të sigurt.

VI. PLANIFIKIMI I EVAKUIMIT TË SHKOLLËS

Përgatitja për emergjencë është hapi i parë drejt një komuniteti më të sigurt dhe madje një bote më të sigurt. Njohja e rreziqeve që ka komuniteti juaj do të ndihmojë në arritjen e këtij qëllimi. Ky aktivitet do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të përgatiten më mirë për çdo emergjencë që mund të vijë duke krijuar planet.

Hapi 1

Krijoni një hartë të shkollës tuaj dhe zonës përreth dhe identifikoni çdo zonë të rrezikshme (lumi afër, raftet e pasigurta, telat elektrikë, gropat, etj.) që duhet të shmangen në një skenar rreziku.

Hapi 2

Punoni së bashku për të përcaktuar dy vende të sigurt ku mund të shkoni nëse ka një emergjencë në shkollë. Sigurohuni që të shmangni rreziqet që keni identifikuar dhe të hartoni rrugët që mund të merrni për të arritur në zonat tuaja të sigurt.

Hapi 3

Punoni me administratorët e shkollës për të miratuar hartën dhe vendet e evakuimit për të bërë një kopje të pastër dhe përfundimtare të hartës. Bëni kopje të të dyjave dhe postojini nëpër komunitet. dërrasë, markera me ngjyra, stilolapsa, shirit

Hapi 4

Sigurohuni që të punoni me administratorët e shkollës për të praktikuar evakuimet 2 herë në vit.

NDIQNI GJITHASHTU KËTO KËSHILLA

1. Vlerësoni në një kohë të arsyeshme nëse situata përbën një emergjencë civile.

Duke përdorur aftësitë personale dhe kompetencat profesionale, eksperiencën tuaj vlerësoni nëse situata është emergjencë civile. Mos e merrni këtë vendim në mënyrë individuale. Sigurimi i një mbledhjeje emergjente do të ishte rasti ideal për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe për të vlerësuar se jemi në kushtet e emergjencës civile.

2. Vlerësoni në mënyrën e duhur llojin e emergjencës civile.

Përpara se të kaloni te veprimet e duhura dhe plani konkret, evidentoni llojin e emergjencës civile: tërmet, fatkeqësi natyrore, pandemi, endemi, krizë humanitare, raste konflikti rajonal apo kombëtar etj. Pasi të keni marrë informacionin e duhur zyrtar në evidentimin e emergjencës civile, identifikimi i llojit të emergjencës civile do të përcaktojë përfshirjen tuaj në menaxhimin e situatës.

3. Përcaktimi dhe referimi i duhur në burimet e informacionit

Për të shqyrtuar me gjykim të shëndetshëm profesional, burimet e informacionit nuk duhet të limitohen te informacionet e medias dhe të mbeten të izoluara në nivel vendor. Duhet të referoheni në:

a. media

b. kompetencat profesionale dhe të emergjencave civile

c. Qeveria: Ministria e Punëve të Brendshme: Drejtoria e Emergjencave Civile, Rezervat Materiale të Shtetit, Ministria e Shëndetësisë

d. Informacione praktike të ofruara nga organizata humanitare ndërkombëtare: UNHCR, Save the Children, UNICEF etj

e. Dokumentat politik-ligjorë: Plan i Kombëtar i Emergjencave Civile, Plan Vendor i Bashkisë për Menaxhimin e Emergjencave Civile, rregullore të brendshme të bashkisë, akte të tjera të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv kur është e nevojshme.

4. Përcaktoni qartë dhe bëni evident rolin tuaj në menaxhimin e krizës

Strukturat e shkollave profesionale kanë një rol thelbësor në identifikimin e rastit dhe në menaxhimin e tij (zgjidhjen e situatave). Është e rekomandueshme që të bëhet një ndarje e balancuar e stafit për identifikimin dhe menaxhimin. Jo e gjithë struktura duhet të përqendrohet në menaxhimin e rasteve (psh. Shpërndarja e ndihmave, produkteve farmaceutike etj). Në shumicën e rasteve, ka një rëndësi thelbësore identifikimi i rasteve dhe adresimi i tyre në strukturat përkatëse: Shkolla, Drejtoria Arsimore Rajonale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë, Rezervat Materiale të Shtetit, drejtoritë e financave pranë Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Këshilli i Qarkut etj.

5. Mbajtja e të dhënave narrative dhe database për rastet e menaxhuara si proces i vazhdueshëm dhe gjithpërfshirës

Emergjencat civile, duke qenë se nuk janë situata normale të ushtrimit të detyrës, shpeshherë mbjellin kaos dhe lënë hapësirë për 'humbje të informacionit'. Për të ndjekur zgjidhjen e rastit në faza të ndryshme të tij dhe për të disponuar informacion të nevojshëm është e rekomandueshme që të dhënat të mbledhen e të menaxhohen. Për këtë mund të ndiqen dy modele funksionale:

- A. Caktimi i një personi si 'koordinator informimi' për të mbledhur, mbajtur e disponuar këtë informacion, në mënyrë specifike për ta adresuar këtë të strukturë të tjera kur kërkohet.
- B. Secili punonjës disponon rastet e menaxhuara prej tij duke ia adresuar në mënyrë periodike Koordinatorit të Informimit që mund të jetë caktuar si strukturë specifike nga vetë Bashkia.

6. Jo të gjithë ndërhyrjet varen nga 'financat'

Strukturat e shkollave profesionale, periodikisht duhet të hartojnë apo ndryshojnë në varësi të zhvillimeve ndërhyrjet prioritare, duke bërë një ndarje të qartë ato që kërkojnë mbështetje financiare dhe ato të cilat nuk kërkojnë mbështetje financiare. Në këtë mënyrë, riorganizoni punën duke:

- A. bërë një plan aktiviteteve të cilat janë prioritare, por që mund të realizohen pa prituri financime si psh: mbështetja psikologjike, realizimi i disa aktiviteteve terapeutike për fëmijë apo grupe në nevojë pranë ambienteve ekzistuese në komunitetin, bashkinë tuaj
- B. Duke kërkuar pranë Drejtorisë së Financave, Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak, Qarkut, OJQ, organizatave humanitare financim në varësi të situatave emergjente si psh: shpërndarja e paketave ushqimore, shpërndarja e mjekimeve, ofrimi i mjekimeve të specializuara grupeve në nevojë dhe me sëmundje të veçanta etj.

7. Ndiham DUHET të kërkohet, JO VETEM nga strukturat, por edhe nga grupe vullnetarësh

Shkollat profesionale, nuk konceptohen si 'spiderman' të menaxhimit të emergjencave civile, por ato janë struktura e parë e cila ndeshet në kontakt të drejtpërdrejtë e të menjëhershëm me qytetarët. Në këtë mënyrë, menaxhimi i krizës realizohet nga stafi aktual, staf i shtuar në varësi të ndryshimit të organikës, ndihmës së ofruar nga strukturat e tjera të përmendura në këtë guidë. Një mënyrë shumë e përdorur dhe efikase është thirrja dhe ndërtimi i një grupi vullnetarësh me qëllim menaxhimin eficient. Për këtë mund të ndiqen dy modele:

- A. Ndërtimi 'permanent' i grupeve vullnetare duke disponuar database të plotë dhe kontakte të drejtpërdrejta sidomos me të rinjtë dhe qytetarët që duan të jenë pjesë e kësaj nisme. Një strukturë e tillë ngrihet në mënyrë të vazhdueshme, pa prituri që të ndodhë emergjenca civile.
- B. Ndërtimi 'ad hoc': Thirrjet për grupe vullnetare në momentin kur ndodh emergjenca civile

8. Kujtojeni vetes dhe strukturave të tjera që menaxhimi i emergjencave civile nuk do të thotë vetëm 'zgjidhje', por përfshin edhe mekanizmin e PARANDALIMIT

Në zbatim të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, strukturat e luajnë rol thelbësor në dhënien e ideve, identifikimin e rasteve, kërkesave për zërat buxhetorë në varësi të situatave. Strukturat, përveç Planit Vendor të Emergjencave Civile, duhet të kenë 'de facto' edhe një guidë specifike të shpërndarjes së kompetencave dhe organizimit në rastet e emergjencave civile.

9. Pjesëmarrja në trajnime apo specializime për menaxhimin e krizave humanitare, emergjencave civile

Me qëllim forcimin e kompetencave profesionale dhe aftësive të duhura gjatë menaxhimit të emergjencës civile, stafet duhet të jenë pjesë e trajnimeve të specializuara për emergjencat civile, kryesisht duke iu referuar atyre jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave.

10. Koherenca në informacion dhe veprim

Një situatë emergjente nuk zgjat përgjithmonë me të njëjtin intensitet, ndaj të qenit koherent në informacion me zhvillimet e situatës, si dhe me veprimet e ndërmarra është një element thelbësor që përcakton eficientësinë dhe punën e strukturave.

11. Fundi i emergjencës civile nuk është vetëm kohë për pushim, por edhe për reflektim raportues

Në momentin kur emergjenca civile mbaron, strukturat duhet të konkludojnë me një raport përfundimtar, i cili duhet të adresohet në strukturat e tjera, apo edhe të futet pjesë e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak/Qarkut. Raporti duhet të përmbajë:

- a. Periudhën e emergjencës civile
- b. Llojin e emergjencës civile
- c. Personat e angazhuar dhe rolet e tyre
- d. Database dhe shpjegime narrative aty ku duhet lidhur me menaxhimin e rasteve
- e. Problematikat e ngritura: te cilat strukturë ngecën dhe si është situata
- f. Panoramë të qartë të situatave të 'zgjidhura' dhe 'të pazgjidhura'
- g. Një plan kërkesash për buxhet të nevojshëm apo shtesë
- e. Konkluzione dhe Rekomandime për t'u reflektuar në vendimmarrjet e mëvonshme

12. Menaxhimi i emergjencave civile nuk është veprim aty për aty apo i çastit, nuk varet as nga vullneti personal i punonjësve, por është në vetvete një planizim deri në detaje, një shkollë më vete e punës.

Anekse dhe ilustrime



Bibliografia

Plani Kombëtar i Emergjencave Civile

Ligji nr. 15/2017 ‘Për arsimin profesional në Republikën e Shqipërisë’

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”

VKM 578 dt.03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”

Marrëveshja për Emergjencat Civile mes Shqipërisë dhe Kosovës

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar

Ligji Nr. 163/2014, “Për Urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me Ligjin 120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

VKM nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”

VKM 518 dt 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”

VKM nr.505, datë 13.07.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”

VKM nr. 499, datë 29.8.2018 për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit

VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”

VKM Nr. 136, datë 07.03.2018, “Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrimit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”

Udhëzim nr. 911 dt.27.12.2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”

Udhëzim nr.13, datë 17.12.2012 “Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”

Vendim nr. 327, datë 2.6.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”

Udhëzim nr. 744, datë 15.11.2019 “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)”

Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit”

Vendim nr. 195, datë 11.4.2007 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”

Vendim nr. 821, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale”

Vendim nr. 822, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, në qendrat rezidenciale dhe ditore”

Vendim nr.823, datë 6.12.2006 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat ditore”

Vendim nr.752, datë 8.9.2010 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në nevojë”

Udhëzim nr. 581, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencë shtëpiake, për të moshuarit”

Udhëzim nr.597, datë 22.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror, asistencës shtëpiake për personat me aftësi të kufizuar”

Udhëzim nr. 582, datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, në qendrat shtëpi familje, për fëmijët 16–18 vjeç”

Save the Children International practice and documents for disaster risk reduction such as Lessons Learned from Implementing Integrated Child Protection and Disaster Risk Reduction in the Deep South of Thailand and Mindanao in the Philippines and other relevant documents

Regulation and implementing actions of EU Civil Protection Mechanism and Disaster Risk Assessment from EU Commission

Save the Children Albania practice on DRR

<https://resourcecentre.savethechildren.net/topics/disaster-risk-reduction-drr/>

https://civil-protection-humanitarian-aid.ec.europa.eu/who/about-echo/legal-framework_en

https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Disaster%20Risk%20Reduction%5B1%5D_0.pdf

<https://albania.savethechildren.net/resources/humanitarian/t-48/sort-type-asc>

